



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 4908/1 Prishtinë 07.12. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti Egzon Ahmaxhekaj ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “Krahasimi i strukturave se projektuar dhe të ekzekutuar – ndikimi i deviacioneve në ndikimet e brendshme” në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregulloreve për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Gjatë ekzekutimit të strukturave nga betoni i armuar gjithmonë mund të shtrojmë pyetjen në lidhje me saktësinë e ekzekutimit të strukturës dhe afërsinë e ekzekutimit të sajë me projektin apo me mënyrën e llogaritjes. Si shkak i kësaj qëshije ne kemi trajtuar temën e krahasimit të strukturës së ekzekutuar me atë të projektuar dhe devijimet të cilat mund të paraqiten në ekzekutim.

Puna dhe shtjellimi i temës është ndarë në katër pjesë ose kapituj sipas peshës së zhvillimit të punimit. Qasja në fushën e strukturave, strukturat prej betoni të armuar, projektimi i tyre dhe vlerësimi i kapacitetit të strukturave ekzistuese shtjellohen në hyrje të punimit.

Në vazhdim pas shtjellitimit të hyrjes dhe koncepteve themelore për strukturat analizohen konceptet themelore në lidhje me projektimin dhe llogaritjen e strukturave nga betoni i armuar, përcaktimi dhe projektimi i materialeve strukturore të cilat përdoren rëndomtë tek strukturat përmes klasës së rezistencës së tyre. Teoria e strukturave e cila merr parasysh efektet e rendit të dytë zhvillohet për analizë të ramave strukturore nga betoni i armuar duke përfshirë mos saktësinë gjeometrike - imperfeksionet, defektet gjatë realizimit, saktësia e ekzekutimit, arritshmëria e rezistencës së betonit si dhe faktorëve tjerë të cilët afektojnë punën reale të strukturave krahasuar me punën e projektuar të strukturës.

Në aspektin teorik të strukturave, jashtëqendërsia aksidentale e cila supozohet në shkallë të përqindjes në fazat e projektimit dhe llogaritjes së strukturave nga betoni i armuar bazuar në standardet për struktura të nënshtruara veprimeve horizontale të tërmeteve janë me peshë të konsideruar për elementet strukturore si dhe për tërë strukturën janë shtjelluar në punim, gjithashtu edhe efektet e epjes së elementeve strukturore të ndikuara nga forcat aksiale në shtypje janë pjesë e interesit për efektet e shtuara të analizës së jashtëqendërsive të elementeve strukturore.

Analiza dhe projektimi i veprimeve të jashtme në strukturë, llogaria e ndikimeve të brendshme sipas projektimit, ndikimi i devijimeve vertikale të elementeve strukturore përkatësisht shtyllat si elemente të pjesshme të strukturës në punën reale të tyre nga gjendja reale e krahasuar me vlerat e projektimit dhe më saktësisht krahasohet sipërfaqja e armaturës për prerjet tërthore të elementeve strukturore e cila ishte e projektuar dhe sipërfaqja e armaturës së kërkuar pas llogaritjes së elementeve nga gjendja ekzistuese.

Në fund të punimit, krahasohen rezultatet nga vlerat e projektit me vlerat reale të llogaritura të strukturës dhe elementeve të veçanta strukturore me qëllim që të gjykohej deformimet, deviacionet, gjeometria e elementeve strukturore e ndërtuar në shkallën e rrezikut të kërkesave për strukturat, stabiliteti, funksionaliteti dhe qëndrueshmëria e tyre. Nga krahasimet e rezultateve do të përfundohet se në cilat raste, kur dhe ku duhet të lejohen ose të mos lejohen deviacionet e strukturës ngaqë do të pasojë reduktimi i kapaciteteve mbajtëse të prerjeve tërthore të elementeve strukturore. E gjithë puna është e bazuar nga matjet e shumta të cilat kanë ndodhë në kohë reale në objektin i cili ishte në fazën e ndërtimit dhe duke krahasuar me projektin real të zbatuar për ndërtim.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.